

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Erion Veliaj nesër në Gjykatën e Lartë, kryetarët e bashkive ballkanike deklarató të përbashkët: Shpresoj më se vlerësimi do të jetë i drejtë! (E PLOTË)
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/erion-veliaj-neser-ne-gjykatën-e-larte-kryetaret-e-bashkive-ballkanike--i401168
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 11:17:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 11:13:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	03dcb90961e00274e64ef4ab2e5e9bef6e9d004ed612239020b9e81702a68932
TEKSTI	8d96cbbc1d91a92e3173000fdce2bc0232482d8e756def0be82ff0a1803358d0
PAMJA	d71346ee7d0b1a85a937e7cbfa48008ae27a7c7627f02374f51cda53c2304de5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f7559e897f2d8f52d26efbc04257d35207c716e0fbcd25eb1bdee9f6485993e7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	fa5011856be057622e11e3b7b9503371417a521d23e6e858a13f19aee6db6a1d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/f7559e897f2d8f52d26efbc04257d35207c716e0fbcd25eb1bdee9f6485993e7

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Politikë

14 Shtator 2026, 13:13

Erion Veliaj nesër në Gjykatën e Lartë, kryetarët e bashkive ballkanike deklarata të përbashkët: Shpresojmë se vlerësimi do të jetë i drejtë! (E PLOTË)



Shkruar nga Newsbomb



Ilustrim: Erion Veliaj, kryetari i Bashkisë Tiranë

Anëtarët dhe Kryetarët e Bashkive të Rrjetit B40 të Qyteteve Ballkanike kanë dalë me një deklaratë të përbashkët për gjyqin që do të zhvillohet nesër, më 15 Shtator, në Gjykatën e Lartë për rastin e kryebashkiakut të zgjedhur të Tiranës, Erion Veliaj.

Ai kërkon të dalë nga qelitë e paraburgimit të Durrësit dhe të ushtrojë detyrën që i kanë besuar me votë mijëra qytetarë të Tiranës, ndërkohë që në të gjitha shkallët e tjera, ndryshimi i masës së sigurisë nuk është pranuar.

"Si një rrjet që përfaqëson dhjetëra kryetarë bashkie të zgjedhur demokratikisht në të gjithë Ballkanin, ne shprehim shqetësimin tonë të thellë për vazhdimin e mbajtjes në paraburgim të Erion Veliajt, Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Tiranë, dhe implikimet e saj ndaj shtetit të së drejtës, mbrojtjes së të drejtave themelore dhe demokracinë vendore në Shqipëri", thotë deklarata.

Erion Veliaj ndodhet në paraburgim që prej datës 10 shkurt 2025 dhe mbahet i ndaluar prej 19 muajsh, pa dënim, ndërsa në një vendim të datës 1 korrik 2026, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata e Lartë, në shkallën e mëparshme, nuk kishte kryer shavrtimin kushtetues të domosdoshëm aiatë vendimmarries për vazhdimin e

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

E fshehur në kontejnerin e mishit të pulës nga Brazili, kapet kokainë me vlerë 2 milionë euro në Portin e Durrësit (VIDEO)



Rajoni

Avokatët e Thaçit "shuplakë" prokurorëve të Hagës: Provat e mbledhura janë të paqarta! Keni gjetur dokumente të redaktuara në qese plehrash

Zbulo më shumë artikuj >

paraburgimit të tij.

Gjykata vendosi se gjykatat e shkallëve të mëparshme nuk kishin vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nëse paraburgimi mbetej i nevojshëm dhe proporcional, nuk kishin marrë në konsideratë masa alternative më pak kufizuese, dhe kishin lënë pas dore ndikimin e paraburgimit të zgjatur mbi ushtrimin e të drejtave të tij kushtetuese.

"Në këtë kontekst, dhe duke respektuar plotësisht pavarësinë e procesit gjyqësor, ne shpresojmë që çdo opsion i përshtatshëm të merret në konsideratë me kujdes, në mënyrë që masat e zbatuara gjatë procesit të mbeten proporcionale dhe, aty ku është e mundur, të lejojnë vazhdimin e ushtrimit të mandatit që qytetarët e Tiranës i besuan Kryetarit Veliaj.

Prandaj, ne e presim shqyrtimin e ardhshëm me pritshmërinë se ai do të ofrojë një mundësi domethënëse për të adresuar shqetësimet e identifikuara nga Gjykata Kushtetuese dhe për të siguruar që të drejtat themelore të Kryetarit Veliaj të respektohen plotësisht gjatë gjithë procesit", vijon deklarata.

Deklaratë e përbashkët mbi shqyrtimin nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë më 15 shtator, paraburgimin, shtetin e së drejtës dhe demokracinë vendore të çështjes së Erion Veliajt, kryetar i zgjedhur i Bashkisë së Tiranës

Si një rrjet që përfaqëson dhjetëra kryetarë bashkie të zgjedhur demokratikisht në të gjithë Ballkanin, ne shprehim shqetësimin tonë të thellë për vazhdimin e mbajtjes në paraburgim të Erion Veliajt, Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Tiranë, dhe implikimet e saj ndaj shtetit të së drejtës, mbrojtjes së të drejtave themelore dhe demokracinë vendore në Shqipëri.

Kryetari Erion Veliaj ndodhet në paraburgim që prej datës 10 shkurt 2025 dhe tashmë ndodhet i ndaluar për 19 muaj pa u dënuar. Në një vendim historik të datës 1 korrik 2026, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë konstatoi se Gjykata e Lartë, në shkallën e mëparshme, nuk kishte kryer shqyrtimin kushtetues të domosdoshëm gjatë vendimmarrjes për vazhdimin e paraburgimit të tij. Gjykata vendosi se gjykatat e shkallëve të mëparshme nuk kishin vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nëse paraburgimi mbetej i nevojshëm dhe proporcional, nuk kishin marrë në konsideratë masa alternative më pak kufizuese, dhe kishin lënë pas dore ndikimin e paraburgimit të zgjatur mbi ushtrimin e të drejtave të tij kushtetuese.

Me shqyrtimin e Gjykatës së Lartë të planifikuar për datën 15 shtator, ne besojmë se ky është një rast i rëndësishëm që autoritetet gjyqësore përkatëse t'i kushtojnë vëmendje të plotë dhe të kujdesshme vendimit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të gjitha rrethanave që lidhen me vazhdimin e paraburgimit të Kryetarit Veliaj.

Ne kemi respekt të plotë për procesin gjyqësor në vazhdim dhe për pavarësinë e gjykatave të Shqipërisë. Njëkohësisht, besojmë se kohëzgjatja e paraburgimit, së bashku me konstatimet e Gjykatës Kushtetuese, e bën veçanërisht të rëndësishme që parimet e domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe disponueshmërisë së masave alternative të marrin një shqyrtim të kujdesshëm.

Këto konsiderata janë të rëndësishme edhe në kontekstin më të gjerë të demokracisë vendore. Kryetari Veliaj u zgjodh nga qytetarët e Tiranës dhe mbetet mbajtës i një mandati demokratik. Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias ka theksuar më parë se masat që prekin aftësinë e një kryetari bashkie të zgjedhur për të ushtruar mandatin e tij mund të kenë implikime të rëndësishme për autonominë vendore dhe përfaqësimin demokratik. Ky parim më i gjerë pasqyrohet gjithashtu edhe në Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, e cila i jep rëndësi të veçantë ushtrimit efektiv të mandateve vendore të zgjedhura.

Në këtë kontekst, dhe duke respektuar plotësisht pavarësinë e procesit gjyqësor, ne shpresojmë që çdo opsion i përshtatshëm të merret në konsideratë me kujdes, në mënyrë që masat e zbatuara gjatë procesit të mbeten proporcionale dhe, aty ku është e mundur, të lejojnë vazhdimin e ushtrimit të mandatit që qytetarët e Tiranës i besuan Kryetarit Veliaj.

Prandaj, ne e presim shqyrtimin e ardhshëm me pritshmërinë se ai do të ofrojë një mundësi domethënëse për të adresuar shqetësimet e identifikuara nga Gjykata Kushtetuese dhe për të siguruar që të drejtat themelore të Kryetarit Veliaj të

respektohen plotësisht gjatë gjithë procesit.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka krijuar një mundësi të rëndësishme për shqyrtim të mëtejshëm të situatës së Kryetarit Veliaj. Ne shpresojmë që shqyrtimi i datës 15 shtator do të kontribuojë në një vlerësim të drejtë, të balancuar dhe konstruktiv të çështjes, duke respektuar plotësisht si procesin gjyqësor ashtu edhe mandatin demokratik që populli i Tiranës i besoi Kryetarit Veliaj.

Data: 11.09.2026

Nënshtkruar nga:

Anëtarët dhe Kryetarët e Bashkive të Rrjetit B40 të Qyteteve Ballkanike

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Hënë 12:52

Berisha u prit me këngë e valle në Rinas pas vizitës në SHBA, ironia e Mustafa Nanos: Arsyeja pse shqiptarët nuk votojnë PD-në



Politikë

Niko Peleshi pret të ngarkuarën me punë të SHBA-së Nancy VanHorn në kryesinë e Kuvendit

🕒 E Hënë 11:39



Politikë

Sali Berisha uron për fillimin e viti të ri shkollor, por nuk kursen kritikët për qeverinë: Nisim me 5900 nxënës më pak

🕒 E Hënë 10:22





E Diel 19:31

Engert Pëllumbi i GJKKO-së tha se s'po u lejohet të marrin nga qesja e tyre, reagon Edi Rama: E pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit



Politikë

28 vite nga vrasja e Azem Hajdarit, Flamur Noka me demokratët vizitojnë familjen Hajdari, priten nga bashkëshortja dhe djali i tij: Kujtuam shpirtin e tij luftarak

E Diel 19:18



Politikë

Shkarkoi besniken e Evis Salës dhe emëroi zv.kryetaren e Krujës, Klodiana Spahiu pas akuzave se ajo është kushërira e Linda Ramës: Mënyrë e vjetër për ta goditur (REAGIMI)

E Diel 18:09



E Diel 17:54

"Po Zegjineja e ka blerë shtëpinë!" Marjana Koçeku për jetesën e shtrenjtë në Tiranë, gazetari e ngacmon për ish-kolegen: Unë jetoj me qira, si këtu si në Shkodër



Politikë

Pas akuzave të Egla Cenos, Edi Rama publikon pamjet nga takimi me



Politikë

"Dil jashtë", u përplas me Edi Ramën për "Territorialet", Egla Ceno flet për

banorët e Poliçanit dhe sqaron
reformën territoriale: Çfarë do të
ndryshojë për ju? (VIDEO)

E Diel 17:27

përballjen me kryeministrin: Ai u çua i
irrituar edhe...

E Diel 16:41



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.